

PËRTEJ PERIFERISË SË LËKURËS

Rimendimi, ribërja dhe rimarrja e trupit në kapitalizmin bashkëkohor
nga Silvia Federici

Përktheu në shqip: Kolektivi për Mendim dhe Veprim Feminist

Ligjërata e tretë

Trupi në krizën e sotme të riprodhimit

Ndryshimi i trupit tonë, rifitimi i kontrollit mbi seksualitetin tonë dhe kapacitetit riprodhues kërkon ndryshimin e kushteve materiale të jetërave tona. Deri në çfarë mase ky parim duhet t'i udhëzojë aktivitetet tona individuale dhe ato kolektive është treguar nga kriza të cilën aktualisht jemi duke e përjetuar në ShBA përkundër aktivizmit intensiv feminist të gjysmës së dytë të shekullit të kaluar. Kjo është një krizë e cila ka shumë dimensione: seksuale, riprodhuese, mjedisore, mjekësore e njohëse megjithatë të gjitha me rrënjë në zhvillimet ekonomike dhe sociale të cilat kanë reduktuar në mënyrë drastike kohën dhe burimet në dispozicionin tonë dhe kanë rritur ankthin për të ardhmën dhe dhunën ndaj së cilës jemi të ekspozuar. Ëndrra e kahmotshme e kapitalizmit për ta zgjatur orarin e punës, ulur pagat dhe maksimizimin e punës së akumuluar të papaguar është tashmë plotësisht e jetësuar në Shtetet e Bashkuara. Me të vërtetë, ajo çka Marksi e ka përshkruar si "ligji i përgjithshëm i akumulimit të kapitalit 1-varfërimi relativ i punëtorëve/eve, krijimi i vazhdueshëm i surplusit/popullatave të zëvendësueshme, ç'aftësimi i shumicës së punëve në dispozicion, mbingarkesa në punë në prani të një numri masiv të të papunëve/ave", "kërkesa e atyre që janë të punësuar/a të prodhojnë më shumë punë" (Marks 1990, 793) -është tendenca e cila është duke e qeverisur jetën ekonomike dhe atë shoqërore e për rrjedhojë janë dhe problemet shoqërore të varfërisë së masës, të pastrehëve/ave dhe thellimi i pabarazive dhe dhunës institucionale.

Me të vërtetë, jeta, për shumicën e njerëzve dhe grave mbi të gjitha, i afrohet sot përshkrimit hobbsian të gjendjes natyrore: është e pistë, brutale dhe e shkurtër. Amerikanët që jetojnë mirë, sot mund të jetojnë deri në nëntëdhjetë vite por për ne pjesën tjetër të popullsisë, jetëgjatësia është duke u shkurtuar, me numër të

¹ Marks, Kapitali, Vol. 1. fq. 7, kapit. 25.

vetëvrasjeve dhe abuzimit me droga gjithashtu rekord.² Vetëvrasjet janë duke u rritur në të gjithë sektorët e popullsisë, përfshirë këtu edhe gratë. Në vitin 2017 janë shënuar gjithsej katërdhjetë e shtatë mijë vetëvrasje në Shtetet e Bashkuara e ne kurrë nuk do ta dijmë sa persona të moshuar e kanë lënë vetën të vdesin, pa u vërejtur, kjo sepse një jetë e jetuar në varfëri dhe izolim nuk ka pasur ndonjë kuptim për ta. Shtoja këtë mijëra vdekjeve nga abuzimi me droga, ata/o formojnë një tablo shqetësuese të cilën ne nuk mund ta injorojmë në punën tonë politike.

Në këtë kontekst, unë dua të theksoj ato aspekte të kësaj krize të cilat janë veçanërisht relevante në rimendimin e një agjende feministe. Në të hyjnë stërngarkesa në punë, borxhet, mungesa e sigurisë, jeta si tension i vazhdueshëm dhe rraskapitëse, çdo herë duke menduar për detyrën tjetër e që rezultojnë në probleme shëndetësore, depresion dhe, siç e kemi parë tashmë, në rritje të numrit të vetëvrasjeve.

Përkundër vlerësimeve pozitive e me nota festive të Kombeve të Bashkuara dhe organizatave feministe liberale mbi hapat e mëdhenj që janë bërë drejt emancipimit të grave, situata e shumicës së popullatës femërore nuk ka se ku të shkojë më zyrtë. Pa dyshim, ne sot jemi shumë më pak të lidhura për familjen dhe burrat sesa në të kaluarën. Familja tradicionale më nuk është norma: martesat sot ka shënuar rekordet më të ulëta dhe shumë gra sot kanë një ose dy punë që paguhen, edhe atëherë kur kanë fëmijë të vegjël. Por ne jemi duke paguar një çmim të lartë për këtë autonomi relative të cilën e kemi fituar. Siç e dijmë, shumica e punëve supozojnë që punëtorët/et janë të lirë/a nga angazhimet familjare ose që kanë dikë në shtëpitë e tyre për t'i kryer punët e shtëpisë. Megjithatë, ndonëse 40% e grave janë burimi kryesor i të ardhurave në familjet e tyre dhe pjesa kanë partnerë/e, gjithashtu të punësuar/a, punët e shtëpisë nuk zhduken kur ne punojmë jashtë shtëpisë. Ato bëhen natën, fundjavave -në kohë kur ne do duhej të pushonim ose të bënim aktivitete tjera. Kjo do të thotë që për shumë gra orët e punës për javë sillen mesatarisht nga gjashtëdhjetë deri në nëntëdhjetë orë, siç ka qenë në kulmin e revolucionit industrial, duke filluar nga ora gjashtë e mëngjesit, për të përfunduar në nëntë në mbrëmje. Një sërë raportesh kanë treguar që gratë vështirë se gjejnë më kohë për vetën e tyre dhe jetojnë në tehtë krizave të nervozës, vazhdimisht duke u merakosur, vazhdimisht duke nxituar, në ankth ose në faj, sidomos për shkak se ato nuk kanë mjaftueshëm kohë për fëmijët ose probleme shëndetësore që ndërlidhen me stresin, duke nisur këtu me depresionin. Edhe kështu, shumicës së grave iu është dashur të bëjnë më pak punë shtëpie që nënkupton që këto punë kanë mbetur pa u bërë, kjo pasiqë nuk kanë pasur shërbime të cilat do ta zëvendësonin punën e kryer prej tyre një kohë. E gjithë kjo në një kohë kur programet të cilat do të mund t'i adresonin këto probleme janë duke u ndërprerë.

² Siç ka raportuar Shehab Khan, në the Independent (29 nëntor 2018), "Vetëvrasje në ShBA kanë shënuar rritje rekorde ndër vite, me një rënie të theksuar në jetëgjatësi." Vdekjet për shkak të mbidozës janë rritur, duke kaluar kështu mbi shtatëdhjetë mijë në vitin 2017. Sipas Qendrës për Kontrollimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve, deri në shtatëqind mijë njerëz në ShBA kanë vdekur nga mbidoza ndërmjet viteve 1999-2017, duke opioidet. Çdo ditë, mesatarisht 130 persona vdesin nga mbisoza.

Dikush mund të shpresojë se kriza në frontin shtëpiak mund të kompensohet nga kënaqësitë që gratë mund t'i fitojnë prej punësimit. Megjithatë, për shumicën e grave, puna jashtë shtëpisë nënkupton që ato janë të burgosura në punë të cilat do t'i shkatërrojnë trupat dhe mendjet e tyre -punë ku ti qëndron në këmbë, gjithë ditën, në dyqane, aeroporte dhe supermarkete, shpesh e vetmuar duke pritur klientë, duke shitur të mira të cilat rroga jote nuk mund t'i përballojë ose duke u prangosur për ndonjë ekran kompjuteri në zyrat si kuti, pa dritare. [Ajo] nënkupton të të duhet të paguash për kujdes ditor, transport dhe të varesh nga ushqimet e shpejta në një kohë kur në do duhej të ishim vigjilente/ë për ushqim, duke pasur parasysh përhapjen e pesticideve dhe produkteve transgjenike si dhe rritjes së obezitetit çdokund, përfshirë këtu edhe tek fëmijët. Shtoja kësaj edhe atë se shumë punë nuk ofrojnë pushim shëndetësor ose leje të lehonisë me pagesë dhe që çmimi për kujdes ditor sillet rreth 10,000\$ në vit.

Kjo nuk do të thotë që ne nuk duhet të punësohemi jashtë shtëpisë. Kjo do të thotë që ne duhet ta njohim atë që "zgjedhja" dhe kontrolli mbi trupat tonë nuk mund të arrihet vetëm duke e reduktuar numrin e fëmijëve që i bëjmë ose duke fituar të drejtën për të mos pasur fëmijë e për të punuar për pagë. Është ndërtimi i pushtetit që është i aftë ta detyrojë shtetin të heqë dorë nga burimet për të cilat ne kemi nevojë për familjet dhe komunitetet tona, në mënyrë që ne të mos kemi nevojë t'i bëjmë dy punë, ta harxhojmë të gjithë kohën duke u shqetësuar për para ose të heqim dorë nga fëmijët tanë në surrogaci ose adoptim për shkak se ne nuk mund t'i mbajmë ata/o. "Të dalësh jashtë shtëpisë" dhe "të luftosh për barazi" nuk mjafton. Ne duhet t'i ripërshtatim burimet, të punojmë më pak, të fitojmë kontroll mbi jetët tona dhe të kërkojmë përgjegjësi për mirëqenien e një bote më të gjerë se sa ajo e familjeve tona.

Për të shtuar këtu, varfëria ekonomike është varfëria e të jetuarit në një botë në të cilën, ngado që kthejmë kokën, shohim shenja të vdekjes. Zogjtë po i braktisin qiejtë tanë, lumenjtë janë duke u kthyer në deponi kimikale, ne nuk jemi duke pasur më kohë për dashuri, shoqëri dhe mësim. Kapitalizmi na ka bërë që ta humbim magjinë e jetës nga sytë. Në një takim më rastisi ta takojë një grua që punonte si asistente në shtatëzani.³ Kjo është një praktikë e cila vjen nga lëvizja e drejtësisë riprodhuese. Ajo nënkupton idenë që gratë të cilat kanë histori të keqtrajtimit nga profesionistët mjekësor nuk duhet të shkojnë vetëm në spital për të lindur por me një avokate. Ajo mund të konsiderohet si një hap drejt rindërtimit të komunitetit të grave të cilat kanë qenë prezente gjatë lindjes. Kjo grua ishte pyetur, "Çka është magjikja?". Përgjigja e saj ishte: "Shko shihni ndonjë grua duke lindur. Nuk ka diçka më magjike se kjo: mënyra se si ritmet e nënës koordinohen me ritmet e fëmijës është thjeshtë magjike". Megjithatë, sot ne lindim në hapësira me rreshta të tërë shtretërisht. Siç e ka përshkruar edhe Megan Fox (1989, 125-29) në artikullin e saj mbi kohën subjektive dhe objektive të lindjes, sot "koha e lindjes llogaritet". Lindja është bërë "thjeshtë prodhim". Fokusi është në eficiencën, sikur në ndonjë studim mbi kohën dhe lëvizjen. Lindjet nuk ndjehen. Fëmijët janë duke u nxjerrë jashtë nga trupa të pandjeshëm. Lindja është reduktuar në një proces mekanik.

³ Mbi rëndësinë e rolit të mamive si avokuese të grave lehona, shih Alana Apfel, Puna e lindjes si punë kujdesi (2016)

Natyrë është gjithashtu magjike. Një ditë dhe është i kaftë dhe në ditën tjetër lulet gjenerohen nga ai në të gjitha ngjyrat e mundshme. Si është e mundur që ato ngjyra e forma të atyre luleve janë të prodhura nga po i njëjti dhe, është diçka që ende as shkenca nuk e ka zbuluar. Magjike është bota siç shihet në gjithë kreativitetin dhe vetë-lëvizjen e saj. Është përreth nesh por ne nuk jemi duke e parë atë. Ne e kemi humbur kapacitetin për t'u lidhur me të. Tërheqja mes njerëzve është gjithashtu magjike. Shkollarët e rilindjes kanë folur për "harmoninë e sferave". Ata kanë besuar që universi mbahet nga një forcë dashurie -e ngjashme me efektet e forcës së gravitetit. Ata kanë besuar se fuqia e "tërheqjes" ka mbajtur çdo gjë në vend dhe kjo ka qenë e vërtetë si për njerëzit, si për yjet. Kjo pikëpamje mbi universin si diçka e gjallë, ku gjithëçka është e ndërlidhur na jep fuqi për luftën tonë. Është kundërhelm ndaj pikëpamjeve cinike që thonë se tashmë është shumë e padobishme për të luftuar për ndryshime në botë "sepse është shumë vonë", "gjërat kanë marrë që moti të tatpjetën" e që ne nuk duhet të jemi kurrë aq të afërt me të tjerët sepse nuk mund t'iu besojmë atyre e edhe duhet të mendojmë për vetën tonë fillimisht.

Përpjekjet për ta rikuperuar raportin tonë me të tjerët dhe natyrën nuk janë duke munguar. Gratë, sidomos nga komunitetet vendase, janë duke formuar bahçe urbane, deponi të farave, janë duke i djegur placentat e tyre në tokë për t'i rikujtuar fëmijëve të tyre lidhjet e tyre me dheun. Në Amerikë gjithashtu, në hapësira urbane, bahçet si dhe janë duke u përhapur si dhe forma të tjera të "të përbashkëtave" një herë të limituara vetëm tek grupet radikale. Ne jemi duke u vetëdijësuar që kur humbim raportin me tokën ne humbim shumë më shumë se sa veç një burim ekonomik. Siç amerikanët vendas e kanë ditur gjithmonë, kur humbim tokë, ne humbim dijen tonë, historinë tonë e kulturën tonë. Siç ka pranuar edhe Marksi (1988, 75-76), natyra është trupi ynë jo-organik, një zgjatim i vetës tonë. Për rrjedhojë, vdekja e tokës nënkupton vdekjen tonë. Për këtë, ekzistojnë shumë organizata të grave të cilat janë duke punuar në rikuperimin e formave më të vjetra të dijeve mbi barishtet dhe bimtë.

Tashmë është duke ekzistuar një vetëdije në rritje mbi vuajtjen barbare e cila është duke u shkaktuar mbi kafshët në pothuajse çdo sektor të industrisë. Kafshët, gjithashtu, janë duke u kthyer në makina. Në hambare anembanë vendit, të cilat tashmë ngjajnë në impiante industriale ose thënë më mirë në kampe të koncentrimit për kafshë, dritat mbahen ndezur natë e ditë vetëm që pulat të prodhojnë më shumë vezë. E njëjta ndodhë me derret femra. Miliona kafshë rriten veç për t'u ngrënë. Ato nuk shihen si qenie të gjalla por thjesht si makina të prodhimit të mishit, të programuara në atë mënyrë që disa prej tyre asnjëherë nuk mund të çohen në këmbë të tyre para se të dërgohen në thertore sepse pesha e mishit në trupin e tyre është shumë më e rëndë se sa mund ta përballojnë këmbët e tyre.⁴ Nuk është çudi që sot kemi kaq shumë lloje të kancereve. Ne jetojmë në një tokë të helmuar dhe ushqehemi me kafshë të cilat prej që

⁴ Një denoncim i fuqishëm, therës mbi mizoritë e shkaktuara në kafshë feramat industriale ku rriten mijëra prej tyre, para se të sillen në thertore mund të gjindet në librin e Sunaura Taylor Kafshë barre (2017) e cila përderisa zhveshë ferrin e gjallë mbi të cilin është i ndërtuar industria e ushqimit, tregon që degradimi i kafshëve "ka kontribuar në një dhunë të pa folur ndaj njeriut" (107).

janë lindur janë torturuar në mënyrë të tmerrshme -duke e marrë kështu në trupat tanë gjithë helmin që vuajtja e tyre e ka prodhuar.

Siç thashë, ne jemi duke filluar ta zhvillojmë një neveri ndaj kësaj mizorie që i ngjanë nazizmit, të ushtruar ndaj miliona qenieve të gjalla vetëm për të kënaqur dëshirat tona. Lindja e Çlirimit të Kafshëve ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në politikën revolucionare e kështu është duke bërë edhe revolucioni i heshtur ndër shumë të rinjë/reja përreth botës të cilët/at janë duke u bërë vegjetarianë/e apo vegan/e, disa ndoshta për shkak të shqetësimeve për mirëqenien e tyre e disa për shkak të neverisë që ndjejnë ndaj vuajtjes që kërkohet që dëshira jonë për mish të kënaqet.

Prapë, mbetet ende shumë për t'u bërë. Pavarësisht shumë lëvizjeve shoqërore, luftërave shoqërore dhe avancim të të drejtave të njeriut, ne nuk kemi arritur ta adresojmë krizën kryesore mbi të cilën dhe është ndërruar shoqëria amerikane -atë të pasojave të shekujve të skllavërisë dhe gjenocidit, të cilat sikurse një oqean me gjak ndikon dhe deformon çdo gjë që është duke u bërë në këtë vend. Si do të dukej një lëvizje feministe e cila jo vetëm që pozicionohet në luftë kundër racizmit por e vendosë në krye të agjendës së saj atë si krim të patolerueshëm social dhe qëndron kundër institucioneve që e gjenerojnë atë?

Racizmi në të gjitha format e tij është aq shumë i rrënjosur në shoqërinë amerikane dhe atë evropiane saqë zhbërja e saj kërkon një proces të gjatë revolucionar. Megjithatë, një lëvizje feministe mund të mobilizohet kundër politikave dhe institucioneve të cilat e mbështesin diskriminimin racor dhe format e reja të skllavërimit ndaj të cilave jo vetëm zezakët/et por edhe komunitetet latine dhe migrante janë të nënshtruar. Ne kemi gjithashtu nevojë për një lëvizje e cila lufton për zhbërjen e dënimit me vdekje, sistemit ndëshkues dhe militarizmit i cili është duke përshkuar çdo aspekt të jetës tonë. Objektivë feministe duhet të jetë gjithashtu çlirimi i mijëra grave të burgosura në ShBA -që ka përqindjen më të lartë të grave të burgosura në botë, të cilat janë burgosur kryesisht për shkak të "krimeve për mbijetesë" si shitja e seksit ose falsifikimi i çeqeve, e cila për shkak të shtatëzanive tek gratë me të ardhura të ulëta ose grave të zeza është kriminalizuar vazhdimisht.

Ne kemi nevojë për një lëvizje e cila mobilizohet në solidaritet me fëmijët tanë, jetërat e të cilëve çdo ditë po cenohen. Tashmë veç ekziston një shqetësim mbi gjuajtjet me armë të fëmijëve të të gjitha moshave në shkolla e kopshte megjithatë jo aq të qarta sa për të ndryshuar politikat që e rregullojnë posedimin e armëve. Gjithashtu, abuzimet e bëra nga priftërinjë nëpër kisha dhe manastirë për dekada të tëra, janë duke fituar ca vëmendje. Megjithatë, feministëve iu duhet ende për t'u mobilizuar kundër dhunës ndaj së cilës fëmijët janë vazhdimisht të ekspozuar nga institucionet shtetërore dhe shpesh nën pretekstin e mbrojtjes së fëmijëve nga prindërit edhe në shtëpi.

Nëse ne e refuzojmë dhunën që është duke u ushtruar ndaj nesh, me më shumë arsye duhet ta refuzojmë edhe dhunën që është duke iu ushtruar fëmijëve tane. Ne kemi nevojë t'i valorizojmë fëmijët, duke i shikuar si bashkëudhëtarë/e e jo si qenie inferiore.

Fëmijët nuk i kanë përbrendësuar ende humbjet dhe praktikat të cilat na i formësojnë raportet tona me të tjerët teksa rritemi dhe mundem menjëherë të detektojnë se çka është e rrejshme, artificiale. Për këtë, ne kemi shumëçka për të mësuar nga ta/o.

Dhënia fund e të gjitha formave të dhunës që ushtrohet mbi fëmijët është një çështje urgjente, duke qenë se vetë fëmijëria është në gjendje emergjente, me shkolla të cilat në ShBA janë duke u bërë si burgje me detektorë metalikë e roje në dyer. Programet kreative janë hequr fare nga kurrikulat mësimore, të paktën në shkolla publike. E në shtëpi çdo herë e më pak ka kohë dikush për fëmijë. Ne nuk kemi pse të befasohejmë që ata/o janë të palumtur/a dhe rebelë/e. Çka është duke ndodhur është ajo që rebelimi është duke u përshkruar si sëmundje mendore dhe është duke u medikalizuar. Kjo është më lehtë dhe më fitimprurëse sesa njohja e arsyeve të cilat çojnë në pakënaqësinë e fëmijëve. Do të ishte njëmend revolucionare nëse, në vend të shpenzimit të një trilion dollarëshi për të rinovuar sistemin nuklear, qeveria amerikane të shpenzojë një trilion dollarësh për t'u siguruar që shkollat tona stimulojnë kreativitetin e fëmijëve tanë. Kjo është një projekt i mirë feminist dhe një kërkesë e mirë feministe.

Ligjërata e pestë

Ribërja e trupave tanë, ribërje e botës?

Ideja e ribërjes së trupave tanë është shumë e vjetër e po aq e vjetër është edhe dëshira jonë për t'i tejkaluar kufizimet e tyre, për shembull duke kërkuar fuqi si të shtazëve, siç është kapaciteti për të fluturuar. Me të vërtetë, përgjatë historisë qeniet njerëzore i kanë ribërë trupat e tyre dhe të tjerëve përmes shenjave të fytyrës, modifikimeve të kafkës, bërjes së muskujve dhe tatuave. Kjo për shkak të identifikimit grupor, për të projektuar pushtet personal ose kolektiv, për ta zbukuruar vetën.⁵ Trupat janë gjithashtu tekste në të cilat regjimet e pushtetit i kanë shkruar recetat e tyre. Si pikëtakimi mes botës njerëzore me atë jonjerëzore, trupi ka qenë mjeti ynë më i fuqishëm i shprehjes së vetës dhe më lehtësisht i abuzueshmi. Kësisoj, trupat tonë janë dëshmi e dhimbjeve dhe gëzimeve të cilat ne i kemi përjetuar dhe i luftërave të cilat i kemi bërë. Historitë e shtypjes dhe rebelimit mund të lexohen përmes tyre.

Asnjëherë më parë në histori nuk ka qenë kaq shumë e mundshme që të ndryshohet trupi e të jetë objekt i kësaj dëshire intensive. Kur vrapon në park në mëngjes ose kur ecë skaj një palestre sportive natën, e ke një përshtypje të një lëvizje masive që nxjerrin në pah një lloj pasioni i cili në të kaluarën ka qenë i rezervuar për takime politike. Hordhi njerëzish që popullojnë parqet, duke vrapuar në grupe, në dyshe apo individualisht, duke çikluar apo ecur, ndërkohë që palestrat sportive janë duke e ndërruar peisazhin urban me reklamat e tyre mahnitëse të instrumenteve metalike dhe trupave punues, tash çdo herë e më shumë të mbuluar me tatu, herë-herë duke mbuluar gjithë trupin thuajse me një lëkurë të re. E kjo është veç një pjesë -një pjesë e teknologjisë së ulët -e ribërjes. Në nivelin më të avancuar teknologjik, ndjesia që ne jemi duke hyrë në një epokë të re është edhe më shumë e theksuar. Për shkak të teknologjive të reja riprodhuese, gratë mund ta zgjasin periudhën riprodhuese dhe të bëjnë fëmijë edhe pas menopauzes ose t'ua delegojnë grave tjera detyrën e bartjes dhe lindjes së "fëmijëve të tyre". Përmes manipulimit gjenetik -ende në fazë eksperimentuese -doktorët premtajnë eliminimin në lindje të të gjitha prirjeve që çojnë në sëmundje. Gjithashtu, me implantimin e çipave mikro, një botë e re është duke ardhur në jetën e super-burrave dhe super-grave që hapin dyert e veturave e ndërtesave të tyre me një lëvizje dore e që bartin të dhëna vitale të koduara në trupat e tyre. Me fuqitë që njëherë kanë qenë subjekte të mitologjisë⁶, kirurgët tani janë duke e ribërë gjininë, në një kohë kur edhe shkencëtarët/et më kërkues/e fantazojnë për atë ditë kur fokusi ribërjeve do ta lënë trupin prapa, ta tejkalojnë, ta hedhin atë, ta zhvendosin mendjen në cirqe elektronike më pak të prishshme.⁷ Në ndërkohë, operacionet plastike dhe kozmetike

⁵ Mbi këtë çështje, shih Polhemus (1978)

⁶ Këtu jam duke iu referuar legjendës të treguar në Simpoziumin e Platonit i cili e përshkruan zhytjen e Apolos, i ndarë në dysh, duke sfiduar perënditë, qeniet e para dhe më pas, sikurse kirurgu modern, duke i kthyer gjenitalet e tyre, duke i qepur aty-këtu, duke i bërë qeniet njerëzorë në formën që ne i njohim sot, të pakompletuar, në mungesë të pjesëve të tyre të prera, për shumë vite në kërkim të gjysmës tjetër të tyre.

⁷ Shih: Finn Bowring, Shkenca, Farat dhe Kiborgët (2003), veçanërisht kapitullin e 11: "Zgjidhja e kiborgut".

janë vazhdimisht në nivele të larta, sidomos tek gratë. Miliona hundë, buzë, gjinjë e madje labia vagjinale janë duke u rimodeluar, rrudhat duke u zbutur prej ballëve të vjetërueshëm e ky trend është veç duke u rritur.⁸

Çka tregon popullariteti i tanishëm i ribërjeve të trupit?

Çka është duke na treguar e gjithë kjo për konceptimet e ndryshueshme të trupave tanë? Dhe cila është "politika e trupit" e këtij fenomeni? Në një botë ku çdokund hasim konkurrencë dhe vazhdimisht i nënshtrohemi zhvleftësimit të trupit, ribërjet e trupit janë të rëndësishme si mjete të vetë-valorizimit. "Ribërja" e trupave tanë" është gjithashtu një nevojë në një kontekst në të cilin ne mund të llogarisim çdo herë e më pak se familjet dhe sistemet e shëndetit mund t'i adresojnë krizat e trupëzuara. Të vëmendshme/ëm ndaj kostos shoqërore dhe monetare të sëmundjes dhe faktit që askush nuk është më aty për ne -duke qenë se prindërit, të dashurit/at, shokët e shoqet janë të tej-zgjatur dhe jetojnë në kufi të kapaciteteve të tyre, ne mbajmë dieta, ushtrime, çiklojmë, i mbushim hapësirat e palestrave sportive, meditojmë. Është përgjegjësia jonë nëse sëmundemi, na thuhet. Mjekët nuk na pyesin nëse jetojmë afër ndonjë deponie kimikale ose nëse kemi probleme monetare por na pyesin se sa ujë kemi pirë, sa cigare kemi pirë, sa kilometra kemi vrapuar. Presioni shoqëror është gjithashtu një faktor tjetër. Edhe pse nuk është rregull i shkruar, të jeshë e/i shëndoshë dhe të keshë një dukje të mirë sot është një kërkesë e papërshtatshme për punë dhe një pikë në favorin tonë në ndonjë intervistë apo takim romantik.

Nevoja, sidoqoftë, është veç një anë e manisë aktuale për ribërje [të trupit]. Dëshira është edhe më e rëndësishme.

Përkundër vështirësisë dhe kostos që mund të kenë, terapitë farmaceutike dhe format e tjera të ribërjes së trupit mund të ofrojnë një zgjidhje më premtuese -për ato/a që mund t'i blejnë ato -sesa të presësh për zhvillimin e një shoqërie të barabartë ku dukja nuk ka më rëndësi. Në anën tjetër, politika e ribërjes së trupit është në shumë mënyra problematike. Përveç rrezikut të spekulimit mjekësorë dhe keqpërdorimeve, ekziston gjithashtu një shqetësim tjetër që ribërjet e trupit mbesin zgjidhje individuale dhe i shërbejnë procesit të stratifikimit shoqëror dhe përjashtimit, duke qenë se "kujdesi për trupin" kërkon më shumë para, kohë dhe qasje në shërbime e burime se që mundet shumica ta përballojë, sidomos kur është fjala për operacione. Tashmë veç fotografitë janë turbulluese. Përderisa trupat e disave janë duke u bërë më fit, më perfekt, numri i atyre të cilët mezi lëvizin për shkak të mbipeshës, sëmundjeve dhe ushqimit të dobët është duke u rritur. *Trupat dhe botët po largohen nga njëra-tjetra.*

Tashmë një "politikë e re e trupit" është në pyetje që mund të na tregojë se si menaxhimi i trupave tanë dhe ribërjet e tyre, mund të zënë vend në një proces më të

⁸ Kirurgjia kozmetike e fytyrës është shumë më shumë e zakonshme sot se sa që ka qenë në të nëntëdhjetat jo vetëm si ndërhyrje kundër plakjes. Chiara Toenley shkruan në Lajmet Mjekësore (17 mars, 2019) se "Kirurgjia kozmetike është në rritje, tregojnë të dhënat." Ndonëse shumica e atyre që i bëjnë ndërhyrjet kozmetike janë gra, numri i burrave është gjithashtu "i madh". <https://www.medicalnewstoday.com/articles/324693.php>

madh të emancipimit shoqëror, kështu që strategjitë e tona për mbijetesë nuk i japin edhe më tej pushtet forcave shoqërore të cilat janë duke na dërguar një pjesë të madhe prej nesh drejt vdekjes dhe që nuk i kontribuojnë një mirëqenieje, çmimi dhe përmbajtja e së cilës është duke na distancuar nga njerëzit e tjerë.

Për gratë, rreziku i shtuar qëndron në pranimin e një disipline estetike të cilën ne e kemi refuzuar në të shtatëdhjetat. Në lëvizjen feministe ne kemi refuzuar të ndahemi në të bukura dhe të shëmtuara dhe t'i konformohemi modeleve më të fundit të bukurisë të imponuara në ne, të cilat shpesh janë ndjekur me dieta të dhimbshme e me çmim të shëndetit tonë.⁹ Për më tepër, me lindjen e feminizmit dhe me lindjen e *Black Poëer* bukuria gjithashtu është ridefinuar. Ne e kemi parë njëra-tjetrën të bukur sepse ne kemi qenë mospërfillëse; sepse duke çliruar vetën tonë nga përshkrimet e një shoqërie mizogjene, ne kemi eksploruar mënyra të reja të të qenurit, të të qeshurit, të të përqaftuarit, të mbajtjes së flokëve, këmbëve tona, mënyra të reja të të qenurit bashkë e të bërit dashuri.

Ne gjithashtu patëm zhvilluar një mosbesim të shëndetshëm në profesionin mjekësor i cili për një shumicë sot përmbanë shpresën e një rilindjeje.¹⁰ Ndoshta për shkak se sot shumë gra janë mjekë, frika nga mjekësia si një institucion shtetëror është zbehur. Me zhvillimin e bio-teknologjive, mjekët sot paraqiten madje si magjistarë dashamirës të cilët kanë në duar çelësit, jo vetëm të mirëqenies tonë por edhe të metamorfozave që do të revolucionarizojnë jetët tona. Prapë, ndonëse sot kemi doktorë qëllim-mirë dhe të kujdesshëm, mjekësia si institucion vazhdon të jetë në shërbim të pushtetit dhe tregut dhe ne do bënim mirë mos të harronim historinë e saj si instrument i përhershëm i kapitalit në përpjekjen për ta rigjenerojë njeriun dhe ta thejë rezistencën tonë ndaj eksploatimit. Njëmend, një histori e tërë e mjekësisë do mund të shkruhej nga pikëpamja e funksionit të saj disiplinues. Nga programet e sterilizimit masiv të zbatuara në shërbim të eugjenikës, tek zbulimi i lobotomive, elektrohokëve dhe drogave psiko-aktive, historia e mjekësisë ka shfaqur vazhdimisht një dëshirë për kontroll shoqëror dhe vendosmëri për riprogramimin e trupave tonë të panështrueshëm, në atë mënyrë që na bënë më të përlulur dhe produktiv.

Për shembull, doktorët kanë gisht në luftën ndaj personave inter-seks, lesbikeve, gejëve dhe grave që kanë refuzuar disiplinën e punëve të shtëpisë. Në të pesëdhjetat, zezakët/et e të gjitha moshave dhe fëmijët të klafisikuar si të retarduar i janë nënshtruar eksperimenteve terrorizuese që përfshinin këtu edhe injektime të përsëritura të

⁹ Shih gjithashtu Brandon Baker, "A është kirurgjia plastike e fytyrës ende e famshme?" Philly Voice, 12 korrik, 2018, <https://ëëë.phillyvoice.com/plastic-surgery-still-popular-beauty-facelift/>. Sipas Shoqatës Amerikane të Kirurgëve të Plastikës, kërkesa për formësimin e trupit është duke u rritur. Vetëm në ShBA, 17.5 milion njerëz në vitin 2018 kanë bërë kirurgji plastike dhe kozmetike me shumë totale prej 16.5 miliardë dollarë. "Statistikat e reja zbulojnë formën e kirurgjisë plastike", 1 mars, 2018, <https://www.plasticsurgery.org/news/press-releases/new-statistics-reveal-the-shape-of-plastic-surgery>.

¹⁰ Mbi këtë çështje shih librin e mrekullueshëm nga Susan Bordo: *Pesha e papërballueshme* (1993)

materialeve radioaktivë në venat e personave të rritur dhe fëmijëve zezakë.¹¹ Është i jashtëzakonshëm fakti që asnjë nga doktorët që kanë kryer këso eksperimentesh nuk janë gjykuar ose kanë vuajtur ndonjë pasojë penale për veprimet e tyre, teksa në Nuremberg, shkencëtarët nazistë janë dënuar me vdekje për krime të ngjashme. Përkundrazi, disa prej tyre edhe kanë ndërtuar karriera brilante përmes programeve të tilla (Hornblum et al. 2013, 155, 176)

Edhe në versionin e tyre më të mirë, mjekësia dhe praktikat mjekësore janë terrene të minuara, duke iu përgjigjur më shumë nevojave të kompanive të sigurimeve, burimeve financiare dhe krijimit të karrierave sesa mirëqenies, duke premtuar zgjidhje që shpesh kthehen kundër nesh. Kini parasysh këtu, kampanjën terrorizuese e cila vazhdon ende e që synon të na bëjë me dije për gjenet me defekte në ADN-në¹² tonë, të gatshme për të zënë fill në ne, për të na çuar kështu drejt varrit. Aq terrorizuese ka qenë e gjithë kjo kampanjë, saqë gratë tashmë janë bindur t'i nënshtrohen operacioneve për heqjen e gjirit si masa radikale parandaluese, një procedurë traumatike kjo, me pasoja të panjohura, me potencial për ta rrezikuar shëndetin e tyre ndoshta më shumë sesa evoluimi i gjeneve me defekte. Në ndërkohë, ujërat, ushqimet dhe ajri ynë janë duke u kontaminuar çdo herë e më shumë, stresi dhe gjendja e pashpresë, në një kohë ku jemi të mbingarkuar me punë, me mungesë të shpresës për të ardhmen dhe pasigurisë së ekzistencës tonë janë duke eskaluar. Alergjitetë të cilat nuk i kanë prekur gjeneratat e më hershme, kanë arritur shtrirje epidemike e gjithë kjo pa denoncim mjekësor të shkaktarëve të këtyre sëmundshmërive, të ditura tashmë dhe me një organizim të sforcuar në kërkim të ndryshimeve. Gratë janë posaqërisht të prekura prej mënyrës së papërgjegjshme me të cilën doktorët i janë qasur kujdesit të trupave tanë. Mendon për të gjitha ato gra të cilat kanë zhvilluar kancer për shkak të implanteve me silikon të aprovuara nga doktorët që janë vendosur në gjinjte e grave për t'i rindërtuar gjinjte e tyre dhe të shpërndarjen e pakontrolluar të kontrceptivëve si Depo Provera dhe Norplant që demonstrativisht janë të dëmshme për shëndetin e grave, duke funksionuar më shumë si instrument i kontrollit shoqëror se sa si mjet për vetëvendosje. Mendoni për rritjen e numrit të lindjeve të panevojshme cezariene. E këto janë veç pak nga shembujt.

Ëndrra karteziene e kapitalit

Tutje, siç ka shpjeguar Finn Boëring në librin e tij "Shkenca, farat dhe kiborgët (2003), ne jemi duke hyrë në një fazë të re në të cilën krijimi i një qenie njerëzore "jomateriale", të lirë nga pengesat e shfaqura nga një kornizë e kufizuar biologjike që është zhvilluar ndër miliarda vite. Shkurt, krijimi i një njerëzimi të pa trupëzuar, sot është haptazi duke u

¹¹ Intensiteti dhe fuqia e mosbesimit më është kthyer nga rileximi i Barbara Ehrenreich dhe Deidre English, Shtrigat, mamitë dhe infermieret (2010) i cili fuqishëm e ilustron atë se si historia e lindjes së profesionit mjekësor ka ndodhur në të gjitha fazat, përmes shtypjes së praktikave shëruese të grave, të arrirë përmes përndjekjes së shërueseve si shtriga dhe zhvendosjes së mamive dhe ka qenë një instrument i disiplinimit të grave

¹² Mbi këtë çështje, përveç James H. Jones, Gjaku i keq (1993) shih gjithashtu A.M. Hornblum, Judith L., Newman dhe Gregory J. Dober, Kundër vullnetit të tyre: Sekretet e historisë së eksperimentimit në Amerikën e luftës së ftohtë (2013) dhe Eileen Welsom, Eksperimenti i plutoniumit (1993).

mbajtur si ideal shoqëror. Siç thekson Boëring, ndër të tjerë, kjo ndërmarrje e re nuk është duke u zhvilluar në vakuum. Që nga të tetëdhjetat, konceptimet mekanike të trupit si harrim i mekanizmave të deqendëruar, të ri-organizueshëm sipas vullnetit dhe dëshirës tonë, kanë qarkulluar në filozofi, sociologji e edhe në teorinë feministe. Prej refuzimit të domosdoshëm të ndarjes dikotomike natyrë/kulturë, është ngjizur ideja e të kuptuarit e biologjisë si diçka që mund të ri-organizohet ose të ribëhen, gjë që ka ndikuar të kuptuarit e pasojave të eksperimenteve mjekësore me trupat tanë. Kështu, nëse veç analiza e Boëring del të jetë e saktë, klonimi, ndërhyrjet në gjene dhe transferimi i gjeneve janë të gjitha në agjendën e ribërjes së njeriut, pasi që të jenë aplikuar tashmë në krijimin e llojeve të reja të bimëve e kafshëve.¹³ Një shtysë e kërkimit shkencor është e orientuar drejt gjetjes së mënyrave se si të çlirohemi prej kufizimeve të imponuara nga veprimet tona dhe prej biologjisë, për shembull duke e rritur kapacitetin e trurit përmes protezave elektronike të cilat na mundësojnë të mendojmë dhe të lexojmë më shpejtë, të kemi më shumë hapësirë për memorie dhe të harxhojmë çdo herë e më pak kohë në gjendjet fizike të strukturës së trupore, siç është nevoja e përsëritur për ushqim dhe gjumë.

Nuk ka asnjë dyshim që veç një pjesë e caktuar e popullatës mund të klasifikohet për një avancim të tillë. Nëse organizimi botëror i prodhimit është akumulim i kapitalit, ai ka ende nevojë për trupa të nxehtë për t'i eksploatuar, përfshirë këtu edhe trupat e fëmijëve, sado pak të dobishëm që mund të jenë, nga këndvështrimi i ëndrrës së kapitalit për një botë kiborgësh (gjysmë njeri -gjysmë robot). Modifikimi ose zëvendësimi i trupave tanë të vjetër/të fundëm me alternativa teknologjike është duke u bërë një nevojë nxitëse tek planifikuesit kapitalist (e edhe nga disa majtistë/e gjithashtu) janë duke e parë hapësirën si një front të ri të prodhimit, në ndërkohë makina programuese janë duke u prodhuar asisoji që janë duke i tejkalar kapacitetet tona për t'i përdorur ato. Për ta përmbledhur, ëndrra e dr. Frankenstein është kthyer prapë në tavolinë, jo vetëm në formën e një roboti në formë të njeriut por edhe si një qenie njerëzore e avancuar teknologjike e një lloji për trupin e së cilës tashmë janë duke u përgatitur implantime teknologjike.

Ribërje e trupave tanë apo ribërje e mjekësisë?

Çfarëdo të jetë shkalla apo fushëveprimi i ndryshimit të kërkuar, ne mund të jemi të sigura/ë që mjekët do të jenë protagonistët e këtij procesi. Rrjedhimisht ne duhet të jemi të shqetësuar/a që hulumtimi mjekësor, në dukje të parë i drejtuar për qëllime tjera, të jetë instrument për bërjen e kapërcimit evolucionar në bërjen e realitetit tonë trupor i cili nuk duket se është i inspiruar në përmirësimin e mirëqenies tonë. Siç ka treguar historia e eugjenikës dhe eksperimenteve mizore në zezakët, përfshirë këtu edhe fëmijët që pat mbërritur majën gjatë dhe pas luftës së ftohtë, mjekësia në ShBA ka

¹³ Prapë, në gusht të 2019-ës, Instituti Kombëtar kundër Kancerit ka lëshuar një udhëzues i cili i fton gratë të cilat kanë pasur kancer të gjirit t'i bëjnë testet BRCA për ta vlerësuar rrezikun e kancerit ovarian dhe të gjirit, pavarësisht të dhënave që kanceri i gjirit është më së shumti i shkaktuar nga faktorët e jashtëm mjedisor siç janë dozat e larta të pesticideve të pranishme (për fillim) dhe ushqimit e ujit që konsumojmë.

një histori të errët e cila duhet të na bëjë vigjilente/ë për dhuratat të cilat na i premtan dhe për pushtetin që e merr nga pëlqimi ynë.

Andaj, ne duhet ta evitojmë bërjen e profesionit mjekësor një krijues -alla zot- të trupave tanë dhe në vend të kësaj ta drejtojmë aktivizmin tonë në gjetjen e mënyrave se si mund të ushtrojmë kontroll mbi përfshirjet tona me të. Tashmë ka mjaftueshëm shembuj të kësaj. Në mesin e shekullit të nëntëmbëdhjetë, një Lëvizje Popullore e Shëndetit pati zënë fill në ShBA, e që ka inkurajuar njerëzit të zhvillojnë dijet e tyre mjekësore, teksa e gjykonte mjekësinë zyrtare me dyshim si një operacion elitist dhe jodemokratik.¹⁴ Në të shtatëdhjetat, feministet në Chicago dhe pjesë të tjera të vendit patën krijuar klinika të nëntokës për të kryer abort, në rast se do vazhdonte të ishte i jashtëligjshëm. Më vonë, në të tetëdhjetat, ACT UP (Koalicioni i *Unleash Power, AIDS*), në përgjigje të mungesës së vëmendjes nga administrata e Reganit ndaj krizës së AIDS-it, pat krijuar një rrjet mjekësh, hulumtuesish, punëtorëve/eve të kujdesit si dhe aktivistësh/esh gejë, në kërkim të ilaçeve të reja, duke i bërë kështu presion kompanive farmaceutike për t'i ulur çmimet e ilaçeve jetike, në një proces i cili po i tregonte botës vendosshmërinë dhe kapacitetin e tyre për t'u kujdesur për vllëzërit e tyre gejë. Që të dyja, lëvizja feministe vetë-ndihmuese dhe ajo ACT UP kanë pasur një ndikim të fuqishëm në mjekësinë zyrtare, duke treguar prapë një shembull të asaj se çka do të thotë kujdesi. Teksa teknologjitë mjekësore prirën për ta ribërë trupin tonë, vazhdojnë të përhapen, të kuptuarit e efekteve që ato do kenë në shëndetin tonë, avantazhet që i ka, atë se sa me të vertetë kemi nevojë për to ose nëse ne jemi duke u përdorur thjeshtë si subjekte eksperimenti, bëhen çështje urgjente për t'u trajtuar. Pak nisma të tilla ekzistojnë sot. Përvoja e ACT UP nuk është përsëritur. Hiq këtu rrjetëzimin në rritje të projekteve mbi shëndetin e grave të zeza, mobilizimi rreth kujdesit për trupin kryesisht janë duke u organizuar nga lart -shihni marshet dhe maratonat të cilat organizohen për trajtimin e kancerit, kancerit të gjirit e kështu me rradhë -që na mobilizojnë të dërgojmë fonde për institucione të ndryshme por që dështojnë të na i zgjerojnë njohuritë tona lidhur me atë se çka mund të bëhet për ta parandaluar sëmundjen.

Si përfundim, raporti ynë me bërjen dhe zhbërjen e trupave tonë -qoftë në trajtim të sëmundjeve, rimodelime kozmetike ose ribërje strukturore -varet nga një institucion i cili udhëhiqet nga parime komerciale dhe qeverisëse. Megjithatë, ende ekziston një mundësi e ndarjes së dijes mjekësore, shqetësimeve dhe frikave me të tjerët në lagje, qytete dhe për t'u rrjetëzuar me infermierë e doktorë të vullnetit që punojnë brenda këtyre institucioneve dhe kjo mundësi duhet të zhvillohet, në mënyrë që ne të mund të krijojmë një botëkuptim kolektiv mbi atë se çka është e përfshirë në transformimet të cilat ne i kryejmë në trupat tonë dhe një pushtet kolektiv për ta fituar kujdesin mjekësor për të cilin kemi nevojë. Pa dyshim, të bërit pjesëmarrës/e në vendimarrjet të cilat na i ndikojnë jetat tona dhe mbrojtja e këtyre vendimeve nga konsideratat komerciale apo eksperimentet në njerëz do të sjellin ndryshim në jetët tona në mënyrë më të thellë se sa ato që prodhohen nga çfarëdo ribërje e trupit.

¹⁴ Mbi krijimin e kafshëve me karakteristika të reja përmes transferimit dhe injektimit të ADN-së nga kafshët në speciet tjera, shih Bowring (2003), 117-22.

Ligjërata e shtatë

Me filozofi, psikologji dhe terror: Transformimi i trupave tanë në fuqi punëtore

Brenda sistemit kapitalist, të gjitha metodat të cilat synojnë rritjen e produktivitetit të punës kanë për çmim punëtorin individual; të gjitha mjetet e zhvillimit të prodhimit e transformojnë vetën e tyre në mjete të dominimit dhe eksploatimit të prodhuesve të punës: ato e gjymtojnë punëtorin në një fragment të njeriut, e dregadojnë atë në atë nivel të një shtojce të makinës, e shkatërrojnë çdo mbetje të hijeshisë së punës së tij dhe e kthejnë atë në një punë të urryer; ata e tëhuajësojnë atë nga potencialet intelektuale të procesit të punës në proporcionin e njëjtë me të cilin shkenca përfshihet në të si një fuqi e pavarur; ata i përkeqësojnë kushtet e punës, duke e nënshtruar atë nën tirani të urryeshëm për poshtërsinë që përmbanë përgjatë procesit të punës; ata e kthejnë jetën e tij në një kohë pune.

-Karl Marks, Ligji i përgjithshëm i akumulimit kapitalist, vol. 1

Pavarësisht sa shumë e deklaron pseudo-tolerancën e saj, sistemi kapitalist në të gjitha format e tij... vazhdon t'i shtypë të gjitha dëshirat... deri në diktaturën e organizimit të tij totalitar, i ndërtuar në eksploatim, varfëri... fitim, produktivitet... Pa u lodhur e vazhdon punën e tij të pistë... duke shtypur, torturuar dhe duke na ndarë trupat tanë me qëlim që të kalisë ligjet e tij në mishin tonë... Duke përdorur çdo rrugë në dispozicion që çonë në organizmat tonë, ai lëshon brenda thellësisë tonë rrënjët e vdekjes së tij.

-Félix Guattari, Përmbysje të buta, 1996

Aftësia jonë për t'i rezistuar kontrollit ose nënshtrimi ynë ndaj tij, duhet të vlerësohet në nivel të çdo lëvizje tonë.

-Gilles Deleuze, Negociatat, 1995

Hyrje: Pse trupi?

Janë disa arsye se pse ne duhet të flasim për trupin, pavarësisht literaturës së gjerë që ekziston tashmë lidhur me këtë çështje.¹⁵ E para, ekziston një e vërtetë e vjetër që "në fillim ishte trupi" me dëshirat e tij, fuqitë e tij, me format e shumëfishta të tij të rezistencave ndaj eksploatimit. Siç është e njohur tashmë, nuk ka ndryshime shoqërore, kulturore ose risi politike që nuk janë të shprehura përmes trupit, e as ndonjë praktikë ekonomike që nuk është aplikuar në të (Turner, 1992). E dyta, trupi është në qendër të të dyjave: i debateve kryesore filozofike të kohëve tona dhe i revolucionit kulturor që po vazhdon në disa aspekte, projekt ky i inauguruar nga lëvizjet e viteve të gjashtëdhjeta

¹⁵ Një version i mëhershëm i këtij artikulli është prezantuar në Konferencën mbi Psikologjinë Teorike të mbajtur në Selanik me 27 qershor, 2011

dhe shtatëdhjeta të cilat e kanë sjellë çlirimin nga instiktet në ballë të punës politike. Megjithatë, arsyeja kryesore se pse ne sot duhet të flasim për trupin është se si rimendimi i mënyrës se si kapitalizmi e ka kthyer trupin tonë në një fuqi punëtore na ndihmon të pozicionohemi në kontekstin e krizës nëpër të cilën trupat tanë janë duke kaluar dhe në të njëjtën kohë, të mund t'i kuptojmë patologjitë tona kolektive dhe individuale në kërkim të paradigmave të reja antropologjike.

Korniza teorike të cilën e kam propozuar dallon nga metodologjia e marksizmit ortodoks dhe nga shpjegimet mbi trupin e regjimet disiplinuese të propozuara nga teoritë post-strukturaliste dhe postmoderne. Përkundër përshkimeve marksiste të "formimit të proletariatit", analiza ime nuk është e kufizuar në trupin i cili është prodhuar nga organizimi i procesit të punës. Siç e ka njohur edhe Marksi, fuqia punëtore nuk ka ndonjë ekzistencë të ndarë; ajo "ekziston veç si kapacitet i individit të gjallë" në një trup të gjallë (Marks 1976, 274). Kësisoj, për ta shtyerë trupin që ta pranojë disiplinimin e punës së varur nuk mund të arrihet vetëm duke i "ndarë prodhuesit e punës nga mjetet e mbijetesës" ose përmes detyrimit të ushtruar përmes kamxhikut, burgut dhe lakut si mjete. Nga fazat e mëhershme të zhvillimit të tij deri sot, për t'i shtyerë njerëzit të punojnë në shërbim të tjerëve, pa marrë parasysh nëse puna ka qenë e paguar apo e papaguar, kapitalizmit i është dashur ta ristrukturojë të gjithë procesin e riprodhimit shoqëror, duke e rimodeluar raportin tonë jo vetëm me punën por gjithashtu edhe me të kuptuarit e identitetit tonë, hapësirës, kohës dhe jetës tonë shoqërore e seksuale.

Rrjedhimisht, prodhimi i trupave punëtorë dhe i "regjimeve disiplinuese" të reja nuk mund ngjizet thjesht për shkak të ndryshimeve në organizimin e punës ose si efekt i "praktikave diskursive" siç propozojnë teoricientet/ët postmodern. "Prodhimi i diskursit" nuk është një aktivitet vetë-rigjenerues e vetë-mirëmbajtës. Është pjesë integrale e planifikimit ekonomik dhe politik dhe i rezistencave që i gjeneron. Me të vërtetë, do mundeshim të shkruanim një histori të tërë të disiplinave -e paradigmave të tij të ndryshueshme e risive -nga pikëpamja e luftërave që i kanë motivuar këto rrjedha.

Konceptimi i trupave tanë në rradhë të parë si diskursiv e injoron gjithashtu faktin që trupi njerëzor ka fuqi, nevoja, dëshira që janë zhvilluar në vazhden e një procesi të gjatë të bashkë-evoluimit me mjedisin tonë natyror dhe si të tillë nuk janë lehtësisht të shtypshëm. Siç e kam potencuar diku tjetër, kjo strukturë e akumuluar e nevojave dhe dëshirave që për mijëra vite ka qenë parakusht i riprodhimit tonë shoqëror, ka qenë një kufizim i fuqishëm i eksploatimit të punës. Pikërisht për këtë arsye, kapitalizmi, që nga fazat e hershme të zhvillimit, është përpjekur ta zbutur trupin tonë, duke e bërë atë shënjeshtë të gjithë asaj çka është materiale, trupore, e fundme dhe e kundërt me "arsyen".

Trupi në kapitalizëm: Nga trupi magjik në trupin makinë

Në librin Kalibani dhe shtriga (2004); unë kam argumentuar që "beteja historike" që kapitalizmi e ka zhvilluar kundër trupit ka lindur prej një perspektive të re politike e cila e ka pozicionuar punën si burim kryesor të akumulimit e për rrjedhojë edhe trupin si kusht i ekzistencës së fuqisë punëtore dhe elementit kyç të rezistencës së shpenzimit të tij.

Andaj, lindja e "biopolitikës" nuk ka ndodhur me qëllim të "menaxhimit të jetës" në mënyrë gjenerike por si proces i cili historikisht ka kërkuar ndryshim shoqëror, risi teknologjike dhe shkatërrim të të gjitha formave të jetës që nuk kanë qenë të përshtashme me organizimin kapitalist të punës.

Në këtë kontekst kam identifikuar sulmet që kanë ndodhur në shekujt gjashtëmbëdhjetë dhe shtatëmbëdhjetë në magjiken dhe lindjen e filozofisë bashkëkohore mekanike si terrene kyçe që kanë çuar në prodhimin e një koncepti të ri të trupit dhe lindjen e një bashkëpunimi të ri mes filozofisë dhe terrorit shtetëror. Të dyja kanë kontribuar, përmes instrumenteve të ndryshme dhe në regjistra të ndryshëm, në prodhimin e një paradigme të re konceptuale dhe disiplinuese, duke e projektuar një trup të privuar nga fuqi autonome, i fiksuar në kohë dhe hapësirë, i aftë për të përbrendësuar forma të sjelljes uniforme, të rregullta dhe të kontrollueshme.

Nga shekulli i gjashtëmbëdhjetë, një makinë disiplinuese veç se ka qenë vendosur në lëvizje e cila pandërprerë i është vënë mbrapa krijimit të një individi të përshtatshëm për punë abstrakte, prapë në nevojë të vazhdueshme për t'u ripërpunuar, përkitazi me ndryshimet e organizimit të punës, format dominante të teknologjisë dhe rezistencës së punëtorëve në nënshtrimin.

Duke u fokusuar në këtë rezistencë, ne mund të shohim që teksa në shekullin e gjashtëmbëdhjetë modeli i cili e ka inspiruar mekanizimin e trupit ka qenë ai i makinës e cila ka lëvizur nga jashtë, sikur pompa dhe leva, në shekullin e tetëmbëdhjetë, trupi tash veç se ka qenë modeluar në një tip të makinës më organike dhe vetëlëvizëse. Me lindjen e *vitalizmit* dhe teorisë së "instikteve" (Barnes dhe Shapin 1979, 34), ne tash e kemi një koncept të ri për truporen që jep hapësirë për një formë të re të disiplinimit, më pak të bazuar në kamxhik dhe më shumë të varur në dinamikat e brendshme të punës, potencialisht një tregues i përbrendësimit në rritje të kërkesave të disiplinimit të procesit të punës nga fuqia punëtore, duke vazhduar me konsolidimin e punës me pagë.

Megjithatë, kapërcimi kryesor të cilin filozofia politike e Iluminimit e ka bërë në armatimin me mjetet e nevojshme për transformimin e trupit në fuqi punëtore, ka qenë arsyetimi shkencor i disiplinës së punës dhe eliminimi i devijuesve. Zëvendësimi i përndjekjes së shtrigave dhe adhurimit të dreqit, nga shekulli i tetëmbëdhjetë, biologjia dhe psikologjia janë përocur për të arsyetuar hierarkitë racore dhe gjinore dhe krijimin e regjimeve të ndryshme disiplinuese, përkitazi me zhvillimin e ndarjes ndërkombëtare dhe gjinore të punës. Një pjesë e madhe e projektit intelektual të iluminizmit është sjellur rreth këtij zhvillimi, qoftë nëse ka shpikur racën dhe seksin (Schiebinger 2004, 143-83; Bernasconi 2011, 11-36) ose ka prodhuar teori të reja monetare të cilat e kanë konceptuar paranë si stimul i punës më shumë se sa regjistrim i pasurisë së kaluar (Caffentzis 2000). Me të vërtetë, ne nuk mund ta kuptojmë kulturën dhe politikën e iluminizmit -debatet mes mongjenistave dhe poligjenistave dhe ri-ndërtimin e psikologjisë femërore dhe mashkullore si pakrahasimisht të ndryshme (Laqueur 1990, 4-6) dhe studimeve kraniologjike "si demonstrim shkencor" i epërsisë së trurëve të

bardhë, mashkullor (Stocking 1988) -përveç nëse i lidhim këto fenomene me natyralizimin e formave të ndryshme të eksploatimit, veçanarisht ato që kanë qenë jashtë parametrin të raportit të pagës.

Është e nevojshme, në këtë kontekst, t'ia atribuojmë gjithashtu lindjen e një lloji më organik të omekanizmit, të dukshëm në shekullit e tetëmbëdhjetë përmes fushës filozofike dhe shkencore edhe rritjes së përçarjes së fuqisë punëtore dhe formimin e një proletariati mashkullor e të bardhë, i cili nuk ka pasur kontroll mbi vetën por siç ka treguar Peter Linebaugh në London Hanged (1992), çdo herë e më shumë e ka pranuar disiplinën e punës me rrogë. Është tunduese, me fjalë të tjera, të mendohet që zhvillimi i teorisë së magnetizmit në biologji, teoria e instikteve në psikologji dhe ekonomi politike (p.sh., "instikti për të tregtuar") dhe roli i elektricitetit dhe i gravitetit në fizikë dhe filozofisë së natyrës -të gjitha duke presupozuar një model të trupit të ngjashëm me mendjen, vetëlëvizëse -reflektojnë në ndarjen në rritje të punës dhe gjithashtu edhe dallimin në rritje me të cilën trupat janë transformuar në fuqi punëtore. Kjo është një hipotezë e cila kërkon ende hulumtim. Çka dijmë sigurtë është që me iluminizëm ne shohim një hap të ri drejt asimilimit të njeriut dhe makinës, rindërtimit të pikëpamjeve të biologjisë njerëzore, duke ofruar kështu bazë për konceptime të reja mekanike për njeriun/natyrën.

Psikologjia dhe transformimi i trupave në fuqi punëtore në periudhën industriale

Ka qenë detyrë e psikologjisë në pjesën e fundit të shekullit të nëntëmbëdhjetë për ta përkryer ndërtimin e "njeriut-makinë", duke e zhvendosur filozofinë në këtë rol strategjik. Për shkak të shqetësimit të tij me ligjer psiko-fizike dhe besimin në rregullsitë e rastësishme, psikologjia është bërë shërbëtore e tailorizmit, në krye të mbajtjes së dëmit të bërë në psiqikën e punëtorëve nga ky sistem dhe për të vendosur raporte të përshtatshme mes njerëzve dhe makinave. Përfshirja e psikologjisë në jetën industriale ka përshkallëzuar pas luftës së parë botërore që krijoi një masë të subjekteve uniforme, të bindshëm dhe të eksperimentueshëm, të disponueshëm për hulumtime klinike, duke ofruar kështu një laborator të frikshëm për studimin e "qëndrimeve" dhe mjetet e përshtatshme të kontrollit (J.A.C Brown 1954; Rozzi 1975, 16-17). Fillimisht e preokupuar me efektet e punës muskulore në trup por shpejt e thirrur për t'u marrë edhe me abstenimin e punëtorëve dhe formave tjera të rezistencave ndaj disiplinës industriale si dhe rezistencave të tyre ndaj vetë metodave dhe teknikave të tyre, psikologjia shpejt është bërë disiplinë e cila merret drejtpërdrejt me kontrollimin e fuqisë punëtore. Më shumë se sa doktorët/et dhe sociologët/et, psikologët/et kanë intervenuar në selektimin e punëtorëve/eve, duke zhvilluar mijëra intervista, administruar mijëra teste dhe duke vendosur për "njeriun më të mirë për punë" për t'i identifikuar frustrimet e vendosur ngritjet në pozitë. (Rozzi, 19).

Përmes atribuimit të patologjive qenësore në organizimin industrial të punës tek një realitet para-ekzistues instiktiv (nevojat, shtysat dhe qëndrimet) dhe veshjes së mantelit shkencor i politikave të diktuara nga kërkesa për fitim, psikologët që nga vitet e 1930a

kanë qenë të pranishëm në dyshemenë e fabrikave, në kohë të caktuara edhe si punëtorë të përhershëm, aty për të ndërhyrë drejtpërdrejt në konfliktin punëtor-kapital. Siç ka theksuar Renato Rozzi në *Psicologji e Operai* (1975), ky intervenim në këtë përpjekje ka qenë vendimtar për zhvillimin e psikologjisë si disiplinë. Kjo pasi që nevoja për t'i kontrolluar punëtorët/et i ka shtyrë psikologët/et të mbështetën në "subjektivitetin" e tyre dhe t'i përshtasin teoritë e tyre karshi efekteve të rezistencës së punëtorëve/eve. Lufta për reduktimin e orarit të punës, për shembull, ka gjeneruar një stuhi të studimeve mjekësore mbi problemin e lodhjes së muskujve, duke e bërë atë, për herë të parë një koncept shkencor (Rozzi 2011, 158).

Sidoqoftë, psikologjia industriale ka vazhduar t'i rrethojë punëtorët/et me një rrjet të kufizimeve -diskursi i shtysave, qëndrimeve, dispozitat instiktuale -të ndërtuara në mistifikimin sistematik të origjinës së "patologjive" të punëtorëve/eve dhe normalizimi i punës së tëhuajësuar. Me të vërtetë, detyra e psikologut ka qenë ta mohojë realitetin e përditshëm të punëtorëve/eve deri në atë masë që shumica e studimeve psikologjike nga kjo periudhë nuk kanë asnjë vlerë, siç thekson Rozzi, përveç se nga aspekti historik ose gjenealogjik. Është e pamundur, për shembull, të pranohen teoritë si ajo e "prirjes për aksident" (Brown 257 -59) të cilat janë përdorur në të 1950-at për ta shpjeguar shpeshësinë e aksidenteve në vendet e punës në Amerikë dhe për ta afirmuar padobishmërinë e përmirësimit të kushteve të punës.

Psikologjia ka qenë gjithashtu qenësore në ri-formësimin e riprodhimit shoqëror, veçanërisht përmes racionalizimit të seksualitetit. Vëmendja e dhënë ndaj ideve të Frojdit për ndërtimin e një koncepti biologjik të feminitetit dhe raportin e tij me krizën e familjes së klasës së mesme me ndërrimin e shekullit (për çka ai ka besuar se është i shkaktuar nga shtypja e vazhdueshme seksuale e grave) e ka zbehur kontributin e psikologjisë e në të njëjtën periudhë e ka disiplinuar seksualitetin e klasës punëtore, veçanërisht të grave të klasës punëtore. Shembull i kësaj është teoria e Cesare Lombroso për prostitutën si "kriminele e lindur" (Lombroso dhe Ferrero [1893] 2004, 182-92) i cili ka nçitur një prodhim të tërë të studimeve antropometrike të cilat e kanë konsoliduar një ide që çdo grua e cila e ka sfiduar rolin e parashkruar femëror ka qenë një kthim në fazat e mëhershme të evolucionit. Konceptimi i "homoseksualitetit" dhe "masturbimit" si çrregullime mendore (për shembull në librin *Psychopathia Sexualis* të Kraft -Ebbingut 1886) dhe rizbulimin e Frojdit në vitin 1905 i "orgazmës vaginale" i përkasin të të njëjtit projekt. Ky trend ka kulmuar me ardhjen e fordizmit, e cila me futjen e punës më pagë pesë dollarë në ditë i ka siguruar punëtorëve shërbimet e grave, duke e lidhur të drejtën e tij për "kënaqësi" seksuale drejtpërdrejt me pagën e tij, duke e bërë kështu seksin si pjesë themelore të punëve të grave. Nuk është aksidentale që përgjatë Depresionit të Madh, gratë proletare të cilat kërkonin lëmoshë janë grabitur shpesh nga punëtorët social kur janë dyshuar për "sjellje të shturura", për shembull në rastet kur ato shoqëroheshin romantikisht me një burrë pa pasur premtim për martesë ato merreshin e dërgoheshin drejt në spitale mendore, nënë duar të psikologëve, detyra e të cilëve ishte t'i bindnin ato t'i lidhnin tubat e tyre nëse do donin ta fitonin prapë lirinë e tyre. Nga vitet e 1950-a, dënimet për gratë rebele ishin edhe më të rënda, me zbulimin e lobotomisë, një trajtim që ishte menduar si efektiv veçanërisht për shtëpiaket

depressive dhe joproductive të cilat e kishin humbur tashmë shijen e punëve të shtëpisë.¹⁶

Psikologjia gjithashtu është dërguar në koloni për ta teorizuar ekzistencën e një personaliteti afrikan, me qëllim të arsytimit të inferioritetit të afrikanëve/eve ndaj punëtorëve/eve evropian/e dhe mbi këtë bazë edhe të dallimeve në pagë dhe segregimin racor. Në Afrikën e Jugut, që nga vitet 1930-a e tutje, psikologët janë instrumentalizuar për aplikimin e ritualeve të degradimit që nën udhëheqjen e "testeve të tolerancës së nxehtësisë" i kanë përgatitur afrikanët për të punuar në miniera të arit, duke i drejtuar ata drejt një situatë pune e cila i privonte nga të gjitha të drejtat (Buchart 93-103)

Kthimi në të tashmen

Çka mësojmë ne sot nga kjo histori komplekse? Mendoj që në të ne gjejmë tri mësimë të rëndësishme. E para, mësojmë që kapaciteti i disiplinës së punës kërkon mekanizimin e trupit, shkatërrimin e autonomisë dhe kreativitetit të tij dhe asnjë aspekt i jetës tonë psikologjike dhe shoqërore nuk duhet ta injorojë këtë realitet. E dyta, duke qenë bashkëfajtorë në transformimin e trupave në fuqi punëtore, psikologët i kanë dhunuar presupozimet e tyre për të bërë shkencë, duke i hedhur poshtë aspektet kyçe të realitetit të cilin ata është pritur të analizojnë, siç është neveria ndaj disiplinës ushtarake që puna industriale e imponon në trupat dhe mendjet tona.

Më e rëndësishmja, një histori e transformimit të trupit në fuqi punëtore e vë në pah thellësinë e krizës që kapitalizmi e ka përjetuar që nga vitet e 1960-a. Kjo është një krizë që klasa kapitaliste ka tentuar ta menaxhojë përmes një ri-organizimi global të procesit të punës por që ka pasur sukses vetëm në rinisjen e kontraditave të cilat e kanë shkaktuar atë në një nivel më shpërthyes. Tashmë është duke u bërë çdo ditë e më e qartë që mekanizmat që më herët e kanë garantuar disiplinën e kërkuar për prodhimin e vlerës nuk janë duke funksionuar më. Lëvizjet e viteve të gjashtëdhjeta dhe shtatëdhjeta kanë qenë një kthesë në këtë pikë, duke e shfaqur kështu një revoltë kundër punës industriale e cila ka investuar në artikullimin e një "fabrike shoqërore", nga linjat e montimit në fabrika e deri te puna e shtëpisë dhe identitetet gjinore funksionale për të dyja. Kërkesa e "jakë kaltërtëve" dhe punëtorëve/eve industrialë/e për më shumë kohë të lirë e jo më shumë para për më shumë punë, refuzimi feminist i natyralizimit të punës riprodhuese dhe linja e lëvizjes gej, së shpejti për t'u ndjekur nga lëvizja

¹⁶ Lobotomia ka qenë praktika dominante për më shumë se dy dekada. Shumica e procedurave të lobotomisë janë bërë në Shtetet e Bashkuara ku që nga të pesëdhjetat përfaqësisht katërdhjetë mijë njerëz janë lobotomizuar, me rastin e parë të bërë në 1936. Viti kulmues ka qenë në vitin 1949, kur më shumë se pesë mijë procedura janë kryer. Lobotomitë janë kryer gjithashtu edhe në Britaninë e Madhe dhe në tri vende nordike si Finlanda, Norvegjia dhe Suedia. Spitalet skandinave kanë lobotomizuar 2.5 herë më shumë për kokë banori se sa spitalet në Amerikë. Shumica dërrmuese e pacientëve të lobotomisë kanë qenë gra. Shih Joel Brasloë, "Efikasiteti terapeuteik dhe konteksti shoqëror: Rasti i lobotomisë në spitalin shtetëror të Kalifornisë, 1947 -1954", Revista Mjekësore Perëndimore 170, nr. 5 (qershor 1999): 293-96. Përkundër humbjes së spontanitetit dhe dëshirave individuale, të dy, doktorët dhe bashkëshortët besonin se gratë e lobotomizuara fitonin shumë nga këto operacione, duke e konsideruar afësinë e tyre për të gatuar, pastruar dhe bërë punët e shtëpisë si pjesë integrale e këtij shërimi.

transeksuale janë shembuj në këtë. kontekst. Ato shprehin një refuzim për ta refuktuar aktivitetin e njeriut në një punë abstrakte, për ta ridefinuar kënaqjen e dëshirave, për t'u lidhur me trupat tanë si makina dhe një vendosshmëri *për ta definuar trupin tonë në mënyra të cilat janë të pavarura nga kapaciteti ynë për të funksionuar si fuqi punëtore.*

Thellësia e këtij refuzimi mund të matet në vargun e forcave të cilat janë angazhuar kundrejt tij. E gjithë bota ekonomike ka qenë ristrukturuar për ta mbajtur atë. Prej lëvizjes tek sistemi i punës së pasigurtë dhe i fleksibilizimi i punës e deri tek ulja e investimeve nga shtet në procesin e riprodhimit shoqëror, një varg politikash kanë tentuar jo vetëm për t'i mundur këto përpjekje por edhe për të kerijuar një disiplinë të re të bazuar në gjithështrirjen dhe hegjemoninë e raporteve kapitaliste.

Institucionalizimi i punës së pasigurtë për shembull, jo vetëm që e ka intensifikuar ankthin tonë për mbijetesë por edhe ka krijuar punëtorë/e të depersonalizuar, të adaptueshëm, gjithmonë në gatishmëri për ta ndërruar profesionin (Berardi 2009a; 2009b). Humbja e identitetit tonë dhe pafuqia janë duke u intensifikuar tutje me kompjuterizimin dhe automatizimin e punës të cilat janë duke promovuar forma të sjelljes shumë të mekanizuara, militariste dhe dehumanizuese, në të cilat personi është i reduktuar në vetëm një komponentë në një sistem më të madh mekanik (Lvidoë dhe Robins, 1989). Me të vërtetë, abstraktëzimi dhe organizimi ushtarak i punës është kompletuar sot dhe kështu është kompletuar edhe ndjesia jonë e alienimit dhe ç'shoqërizimit. Çfarë nivele të stresit është duke prodhuar kjo situatë në jetërat tona mund të maatet me masovizimin e sëmundjeve mendore -panikut, ankthit, frikës, mungesës së vëmendjes dhe përdorimin e drogave nga prozaku te viagra që veç se janë duke eskaluar. Është diskutuar tashmë që edhe suksesi i emisioneve televizive "reality" janë produkt i kësaj ndjesie psikologjike të tëhuajësimit nga jetërat tona. Dëshira për t'i parë tjetër/at teksa jetojnë, çka bëjnë dhe për ta krehasuar vetën me ta/o -gjë e cila, siç treguar Renata Salecl. (2004), e mbanë këtë industri - e zbulon ndjesinë që jeta jonë është duke u humbur, edhe pse të njëjtat programe jane duke çuar më shumë drejt virtualitetit sesa realitetit.

Frika dhe ankthi i shkaktuar nga pasiguria për mbijetesë janë vetëm një aspekt i tmerrit që sot është duke u përdorur strategjikisht për ta ngulfatur revoltën kundër makinës globale të punës. Po aq i rëndësishëm është edhe militarizimi i jetës së përditshme, tash një trend ndërkombëtar. Kjo fillon me politikën e burgosjes masive e aplikuar në të nëntëdhjetat në Shetet e Bashkuara të Amerikës, e që mund të lexohet si një luftë veçanërisht kundër rinisë zezake dhe shpërndarjes së qendrave të ndëshkimit për imigrantë anembanë Komunitetit Evropian. Ne kemi parë gjithashtu një eskalim të ashpërsisë së dënimeve, si gjykimet e detyrueshme, ligjet për recedivistë, përdorimi i armëve për mbrojtje, izolimet dhe rritja e numrit të grave e fëmijëve të arrestuar (ëilliams 2006; Solinger 2010;Donner 200). Tortura është tashmë duke u praktikuar në përditshmëri jo vetëm në "luftëra" poër gjithashtu edhe në burgje të Amerikës. Siç ka sugjeruar Kristian ëilliams (2006) këto as nuk janë anomali e as efekte të paqëllimshme që janë duke dalur nga binarët e drejtsisë. Militarizimi i jetës së përditshme e ndëshkon protestën, e kontrollon ikjen prej ristrukturimit ekonomik dhe e mirëmbanë një ndarje

racore të punës, duke i dhënë shtetit të drejtën për ta shkatërruar trupin e qytetarit.ët (216). Me të vërtetë, sistemi i burgut sot nuk pretendon që ka ndonjë efekt reformues, duke shërbyer në mënyrë të turbullt si një instrument i tmerrit dhe sundimit klasor.

Përdorimi masiv i forcës është ajo çka deri sot e ka nitur revoltën kundër organizimit kapitalist të punës. Por, teksa paaftësia e kapitalit për të na kënaqur nevojat më bazike bëhet çdo herë e më e dukshme, transformimi i trupave tonë në fuqi punëtore bëhet çdo ditë e më problematike. Instrumentet e tmerrit janë duke u thyer. Shikoni refuzimin në rritje të luftës dhe rekrutimit në ushtri që është e dukshme me numrin e lartë të vetëvrasjeve në Ushtrinë Amerikane që tashmë bënë rekrutim në baza vullnetare që ka nxitur një riedukim dhe program fitnesi masiv. Për sa i përket institucionalizimit të punës së pasigurtë, ky është një thikë me dy tehe pasiqë i vendosë kushtet e një denatyrizimi radikal të punës së varur dhe humbjes së aftësive që sociologët/et i kanë konsideruar si të pazhbëshme me në një popullatë industriale. Siç ka dokumentuar Chris Carlsson në veprën e tij Noëtopia (2008), më shumë njerëz janë duke kërkuar alternativa ndaj një jetë të rregulluar nga puna dhe tregu sepse në një regjim të punës së pasigurtë, puna nuk mund të shërbejë më si formacion i identitetit por gjithashtu sepse njerëzit sot duan të jenë më shumë kreativë/e. Në po të njëjtat linja, luftërat e punëtorëve/eve sot marrin tjera forma në krahasim me grevat tradicionale, duke reflektuar këtu një kërkim për modele të reja të njerëzimit dhe raporteve mes qenieve njerëzore dhe natyrës. Ne shohim në to një interes për diskurs dhe praktikë të të "përbashkëtave" e cila tashmë është lindur shumë iniciativa të reja si bankat e kohës¹⁷, shkëmbimet mall me mall, bahçet urbane dhe stukurat e llogaridhënies me bazë komunitare. Ne shohim në to gjithashtu edhe një preferencë për modele androgjene të identitetit gjinor dhe lindjes së lëvizjeve transeksuale dhe interseks dhe një refuzim të gjinisë nga personat queet me te gjithë implikimet e saja në vënien në pikëpyetje të ndarjes seksuale të punës. Më duhet ta përmend gjithashtu edhe përhapjen globale të pasionit për tatu dhe artit të dekorimit të trupit që është duke krijuar komunitete imagjinare e të reja përtej kufijëve të seksit, racës dhe klasës. Të gjitha këto fenomene janë duke e treguar jo vetëm thyerjen e mekanizmave disiplinues por edhe një dëshirë për ta rimodeluar njerëzimin tonë në mënyra të ndryshme ose më mirë të thuhet në të kundërtën e asaj çka shekujt e disiplinës kapitaliste e kanë imponuar në ne.

Ku do ta vendosin vetën psikologët/ët brenda këtij fenomeni? Kjo sot është një pyetje e hapur. Psikologjia ka demonstruar që është e aftë ta transformojë vetën dhe të njohë subjektivitetin e subjekteve të studimit të saj. Megjithatë nuk ka gjetur kurajon për t'u prishur me Pushtetin. Përkundër kritikave radikale të cilave i është nënshtruar në të gjashtëdhjetat nga psikologët/et dhe psikiatrit/ët disidentë/e (si Félix Guattari dhe Franco Basaglia) psikologjia dominante mbetet një bashkëpunëtore e pushtetit. Sot, psikologët/et në Shtetet e Bashkuara janë aktivisht të angazhuar në selektimine teknikave të torturës dhe metodave të marrjes në pyetje. Përkundër Shoqatës Amerikane të Psikiatrisë, Shoqata Amerikane e Psikologjisë deri tash ka refuzuar të

¹⁷ Bankat e kohës janë sistem i tregtisë ku një person e tregton kohën për një shërbim ekuivalente me kohën e personit tjetër.

zbatojë një rezolutë të miratuar nga anëtarët/et e saj, e cila ua ndalon atyre pjesëmarrjen në marrje në pyetje në rastet kur shkelen ligjet ndërkombëtare ose Konventa e Gjenevës.

Psikologët/et duhet fajësuar jo vetëm për veprimet e tyre por edhe për lëshimet e tyre. Me pak përjashtime, ata/o nuk e kanë kritikuar si patogjenike organizimin kapitalist dhe disiplinën e punës por në vend të kësaj e kanë pranuar shitjen e punës si fakt normal i jetës shoqërore, duke e interpretuar revoltën ndaj saj si abnormalitet e cila duhet ngulfatur në një diskurs mbi predispozitat e fiksuar. Një shembull i thjeshtë por shpjegues i këtij lëshimi është mungesa e ndonjë hulumtimi psikologjik mbi rëndësinë dhe vlerën e normave të pagës, me theks të veçantë të rritjeve dhe uljeve në paga si faktor (de)motivues. "Ndonëse ekziston një literaturë voluminoze në vlerësimin e performancës, pak hulumtim shqyrton pasojat e ndërlidhjes së pagesës me vlerësimin e performancës në punë" (Rynes, Gerhart dhe Parks-Leduc 2005, 572-73). Ngjashëm, nuk njihet që çrregullimet mendore mund të jenë të shkaktuara nga faktorët ekonomik si papunësia, mungesa e siguimeve shëndetësore dhe rebelimit kundër punës. Në vend të kësaj, psikologët/et i kanë ndjekur ekonomistët/et në kryerjen e "hulumtimeve mbi lumturinë" në një përpjekje të renovuar për të na bindur që mendimet pozitive, optimizmi dhe mbi të gjitha qëndrueshmëria -fjalë kyçe në qiellin e mjeteve disiplinuese semantike- janë çelësi i suksesit. Mund të theksohet këtu që përfaqësuesi më i njohur "i studimeve të lumturisë" Martin Seligman iu ka ligjëruar Ushtrisë Amerikane dhe CIA-së në gjendjen e "pashresës së mësuar" e cilat presupozohet të zhvillohet si pjesë e procesit të torturës, duke marrë kështu një grant 31 milion dollarësh për t'i trajnuar ushtarët për t'u bërë më të qëndrueshëm kundrejt traumave të nxitura nga lufta (Greenberg 2010, 34).

Ka ardhur koha që psikologët t'i denoncojnë teknikat të cilat janë shpikur për t'i transformuar trupat në fuqi punëtore që pashmangshmërisht çonë nga filozofia në tmerr, nga psikologjia në torturë. Psikologjia nuk mundet më t'i trajtojë më patologjitë e provokuara nga kapitalizmi si një natyrë njerëzore e paravendosur për të prodhuar xhaketa shtrënguese në të cilat i detyron trupat tonë, teksa e injoron dhunimin e përditshëm të integritetit të tyre në dorën e sistemit ekonomik dhe politik në të cilin ne jetojmë.

Ligjërata e dhjetë

Lavdi trupit që vallëzon

Historia e trupit është historia e qenieve njerëzore, kjo pasiqë nuk ka praktikë kulturore e cila nuk është aplikuar së pari në trup. Edhe nëse kufizohemi e flasim për historinë e trupit në kapitalizëm, ne kemi përpara vetës një detyrë dërrmuese, aq të shtrira kanë qenë teknikat të cilat janë përdorur për disiplinimin e trupit, vazhdimisht të ndryshueshme, varësisht nga ndryshimet në regjimet e punës të cilave iu është nënshtruar trupi ynë.

Një histori e trupit mund të rindërtohet duke i përshkruar format e ndryshme të shtypjes që kapitalizmi i ka aktivizuar drejt tij. Por në vend të kësaj, unë kam vendosur të shkruaj për trupin si terren i rezistencës, e që është trupi dhe fuqitë e tij, fuqinë për të vepruar, për ta transformuar vetën dhe trupin si ndalues i eksploatimit.

Ka diçka që ne e kemi humbur në insistimin që trupi është konstrukt shoqëror dhe performativ. Këndvështrimi i trupit si produkt shoqëror (diskursiv) e ka fshehur faktin që trupi ynë është një enë e mbushur me fuqi, kapacitete dhe rezistenca të cilat janë zhvilluar në procesin e gjatë të bashkë-evoluimit me mjedisin natyror si dhe të praktikave ndër-gjeneratash të cilat e kanë shënjuar një kufi të eksploatimit.

Me trupin si "kufi natyror" jam duke iu referuar strukturave të nevojave dhe dëshirave të krijuara në jo vetëm nga vendimet tona të vetëdijshme ose praktikat kolektive por gjithashtu nga miliarda vite të evolucionit material: nevojës për diell, për qiellin e kaltërt, pemët e gjelbërta, erën e pyjeve dhe oqeanëve, për nevojën për të prekur, marrë erë, fjetur e bërë dashuri.

Kjo strukturë e akumuluar e nevojave dhe dëshirave që për mijëra vite ka qenë gjendja e riprodhimit tonë shoqëror, ka vendosur një kufi të eksploatimit tonë dhe kjo është diçka që kapitalizmi vazhdimisht ka tentuar ta tejkalojë.

Kapitalizmi nuk është sistemi i parë i ushqyer me eksploatimin e punës së njeriut. Megjithatë, më shumë se çdo sistem tjetër në histori, ka tentuar të krijojë një botë ekonomike ku puna është parimi kryesor i akumulimit. Si i tillë, ka qenë i pari që ka bërë disiplinimin e ashpër dhe mekanizimin e trupit si premisë kyçe akumulimit të pasurisë. Me të vërtetë, një nga detyrat shoqërore kyçe të kapitalizmit që nga fillet e tij e deri sot ka qenë transformimi i energjive dhe fuqive trupore në fuqi punëtore.

Në librin *Kalibani dhe shtriga* (2004), unë i kam analizuar strategjitë të cilat i ka përdorur kapitalizmi për ta kryer këtë detyrë dhe ta rimodelojë, njëjtë siç ka tentuar të bëjë me tokën, për ta bërë atë më produktive dhe për t'i kthyer kafshët në fabrika të gjalla. Aty kam folur për betejën historike të cilën e ka zhvilluar kundër trupit, kundër materiales tonë dhe për shumë institucione të cilat i ka krijuar për ta përmbushur këtë qëllim; ligjin,

kamxhikun, rregullimin e seksualitetit si dhe një sërë praktikash shoqërore të cilat e kanë ridefinuar raportin tonë me hapësirën, natyrën dhe njëri-tjetrin/ën.

Kapitalizmi është lindur prej ndarja së njerëzve nga toka dhe detyra e parë e tij ka qenë ta bëjë punën të pavarur nga sezonat dhe ta zgjasë orarin e punës përtej kapaciteteve të cilat mund t'i përballojmë. Në përgjithësi, ne e theksojmë aspektin ekonomik të këtij procesi, varësinë ekonomike që kapitalizmi e ka krijuar në baza monetare dhe rolin e tij në formimin e proletariatit që varet nga rroga. Çka jo gjithmonë e kemi parë, ka qenë ajo se çka i ka bërë trupit tonë ndarja prej tokës dhe natyrës e cila e ka varfëruar dhe e ka zhveshur nga fuqitë të cilat popullësitë para-kapitaliste ia kanë atribuar.

Natyra, siç e ka bërë me dije edhe Marksi (1988, 75-76), është "trupit ynë jo-organik" dhe dikur ka qenë një kohë kur ne kemi mundur t'i lexojmë erërat, retë dhe ndryshimet në lumenjë e dete. Në shoqëritë para-kapitaliste, njerëzit kanë menduar që kanë aftësi të fluturojnë, të kenë përjetime jashtë trupave të tyre, të komunikojnë, të flasin me kafshë, t'i marrin aftësitë e tyre dhe t'i ndërrojnë format e trupave të tyre. Ata gjithashtu kanë menduar që mund të jenë në më shumë se një vend, për shembull, të kthehen prej varrit për t'iu marrë hak armiqve të tyre.

Jo të gjitha aftësitë e tyre kanë qenë imagjinare. Kontakti i përditshëm me natyrën ka qenë burim i një sasive të madhe dijeje e cila është reflektuar në revolucionin e ushqimit i cili ka zënë vend sidomos në Amerikat para kolonializimit ose edhe në revolucionin në teknikat e lundrimit. Për shembull, ne tash e dijme që popullatat polenisiane kanë udhëtuar në dete të hapura natën duke i përdorur vetëm trupat e tyre si busulla, duke qenë se ata e kanë detektuar rrugën prej kah ta drejtojnë anijen drejt limaneve në bazë të lëkundjes së valëve.

Fiksimi në kohë dhe hapësirë ka qenë një nga teknikat elementare dhe të vazhdueshme që kapitalizmi i ka përdorur për ta poseduar trupin. Kini parasysh sulmet ndaj vagabondëve, migrantëve dhe endacakëve përgjatë historisë. Lëvizshmëria paraqet rrezik kur nuk ndodhë për hirë të punës, duke qenë se ajo qarkullon dije, përvoja dhe luftëra. Në të kaluarën instrumentet e kufizimit kanë qenë kamxhikët, zinxhirët, shtylla ndëshkimi që vendoseshin në trupat e njerëzve për t'ua pamundësuar lëvizjen, gjymtimi, skllavërimi. Sot, përveç kamxhikëve dhe qendrave të ndëshkimit, kemi mbikëqyrjen përmes kompjuterëve dhe kërcënimeve të përsëritura të epidemive si gripi avian si mjet i kontrollimit të nomadizmit.

Mekanizimi -kthimi i trupit qoftë ai femëror apo mashkullor, në makinë -ka qenë një nga objektivat e pareshtura të kapitalizmit. Kafshët gjithashtu janë kthyer në makina, ashtu që t'i dyfishojnë pjelljet, pulat të mund të prodhojnë vezë pa ndërprerë, teksa ato jorproduktive bluhën e viçat nuk mund të çohen kurrë në këmbë pa u dërguar në thertore. Unë nuk mund t'i shpalosë këtu të gjitha mënyrat në të cilat ka ndodhur mekanizimi i trupit. Mjafton të thuhet se teknikat e zaptimit dhe dominimit kanë ndryshuar varësisht nga regjimi i punës në fuqi dhe makinave të cilat kanë qenë model për trupin.

Për këtë ndodhë që ne e shohim që në shekujt e gjashtëmbëdhjetë dhe shtatëmbëdhjetë (koha e fabrikave) trupi ka qenë i imagjinuar dhe disiplinuar përkitazi me modelin e makinave të thjeshta si pompa dhe leva. Ky ka qenë regjimi i cili ka kulminuar në tajlorizëm, studimin e lëvizjes dhe kohës, ku çdo lëvizje është kalkuluar dhe të gjitha energjitë janë kanalizuar në punë.

Rezistenca këtu është imagjinuar në formën e plogështisë, me trupin e portretizuar si një kafshë budallaqe, një përbindësh që i reziston komandimit.

Në shekullin e nëntëmbëdhjetë në kemi një konceptim të trupit dhe teknika të disiplinimit të modeluara në bazë të motorëve me avull, me produktivitetin e kalkuluar në bazë të hyrjeve dhe prodhimit teksa *efiçienca* fillon të bëhet fjala kyçe. Nën këtë regjim, disiplinimi i trupit është bërë nëpërmjet kufizimeve dietare dhe kalkulimit të kalorive që një trup punëtor duhet t'i ketë. Klimaksi, në këtë kontekst, ka qenë tabela naziste e cila specifikonte se sa kalori i duhen secilit lloj të punëtorit. Armiku këtu ka qenë shpërndarja e energjisë, entropisë, humbjes dhe trazirës. Në ShBA, historia e kësaj ekonomie të re politike filloi në vitet 1880-a, me sulmin e salloneve dhe rimodelimin e jetës familjare që në qendër kishte tashmë gruan si shtëpiake me orar të plotë, e ideuar si një makinë anti-entropike, gjithmonë aty, e gatshme për ta ripërdorur ushqimin e konsumuar, për t'i pastruar trupat e njollosur, e riparuar fustanet e riparuar e të shkyera prapë.

Në kohët tona, modelet për trupin janë ato të kompjuterit dhe të kodit gjenetik të cilat kanë ndërtuar një trup të ç'materializuar e të zbërthyer, i imagjinuar kështu si konglomerat i qelizave e gjeneve, secila me programin e vetë, të pashqetësuar për pjesën tjetër të mirën e trupit si tërësi. Kështu është teoria e "gjenit vetjak"-ideja që trupi është i përbërë nga qeliza dhe gjene individualiste, secila në kërkim të programit të tyre, një metaforë perfekte për konceptimin neoliberal të jetës, ku dominimi i tregut na e shkatërron jo vetëm solidaritetin në grup por edhe solidaritetin me vetën. Vazhdimisht, trupi zbërthehet në një tërësi të gjeneve vetjake, secila duke u përpjekur ta arrijë qëllimin e vetë vetjak, indiferente ndaj interesave të pjesës tjetër.

Në masën që ne e përbrendësojmë këtë pikëpamje, ne e përbrendësojmë edhe përjetimin më të thellë të tëhuajimit të vetës, teksa konfrontohemi me një përbindësh të madh i cili nuk i bindet urdhërave tonë por gjithashtu edhe me të zotin e mikro-armiqëve të cilët janë mbjellë në trupat tanë, gati për të na sulmuar në çdo moment. Industritë janë ndërtuar në frikat që mund t'i gjenerojë një konceptim i tillë i trupit, duke na vendosur neve në mëshirë të forcave të cilat nuk mund t'i kontrollojmë. Pashmangshmërisht, nëse e përbrendësojmë një pikëpamje të tillë, ne nuk kemi ndjesi të mira për trupin tonë. Në fakt, trupi ynë na frikëson e edhe ne nuk e dëgjojmë atë. Ne nuk e dëgjojmë se çka donë ai por i bashkangjitemi sulmeve ndaj tij me të gjithë armët të cilat mjekësia mund t'i ofrojë: rrezatimi, kolonkopia, mamografia, të gjithë bashkë në një luftë të gjatë kundër trupit me neve që bashkohemi në këtë sulm në vend që ta nxjerrim trupin tonë nga zjarri. Në këtë mënyrë, ne jemi të përgatitur për ta pranuar një

botë e cila transformon pjesët e trupit tonë në sende për treg dhe e shikon trupin tonë si një depo e sëmundjeve: trupi si murtajë, trupi si burim i epidemive, trupi pa arsye.

Lufta jonë duhet të fillojë me ripërvetësimin e trupit tonë, rivlerësimin dhe rizbulimin e kapacitetit të tij për rezistencë dhe zgjerimin e festimit e fuqive të tij, individuale dhe kolektive.

Vallëzimi është qëndror në këtë ripërvetësim. Në esencë, akti i vallëzimit është akt i eksplorimit dhe zbulimit i asaj së çka mund të bëjë një trup: i kapaciteteve të tij, i gjuhëve të tij, i artikulimit të përpjekjeve të qenies tonë. Unë tashmë besoj se ekziston një filozofi në vallëzim, duke qenë se vallëzimi imiton proceset me të cilat ne lidhemi me botën, me trupat e tjerë, e transformojmë vetën dhe hapësirën përreth nesh. Prej vallëzimit ne mësojmë që materia nuk është budallaqe, nuk është e verbër, nuk është as mekanike por ka ritmet e veta, gjuhën e vetë dhe është e vetë-aktivizuar dhe e vetëorganizuar. Trupat tanë kanë arsye të cilat ne duhet t'i mësojmë, t'i rizbulojmë dhe rishpikim. Ne kemi nevojë t'i dëgjojmë gjuhët e tyre si rrugë drejt shëndetit dhe shërimit tonë, duke qenë se ne kemi nevojë ta dëgjojmë gjuhën dhe ritmet e botës natyrale si rrugë drejt shëndetit dhe shërimit të tokës. Duke qenë që aftësia për t'u ndikuar dhe për të ndikuar, për t'u lëvizur dhe për të lëvizur, një kapacitet i cili është i pathyeshëm, i shterrur vetëm kur vdesim, është themelore për trupin, ekziston një politikë e përhershme e cila e banonë atë: kapaciteti për ta transformuar vetën, të tjerët dhe për ta ndryshuar botën.



KOLEKTIVI PËR MENDIM DHE VEPRIM
FEMINIST

Prishtinë, qershor, 2022